



IRDK info

Nr. 01-02/13

Fletushkë informative mujore

Janar dhe Shkurt, 2013

24 QERSHORI

“DITA E EGJIPTIANËVE”

NË KOSOVË



Mesazh i kryetarit të IRDK-së Xhevdet Neziraj

Duke ju përshëndetur përzemërsisht, në vitin 2013 iu dëshiroj për një vit të mbarë, me lumturi, paqe dhe harmoni.



Kryetari i IRDK-së merrë pjesë në pritje të delegacionit të Lartë nga Egjipti.



Vazhdimi i kaosit të Egjiptianët dhe Ashkalitë

Trajtimi si çështje dytësore i inicimit të bisedave në mes bashkësisë së njëjtë etnike e tash e dymbëdhjetë vjet ...

IRDK miraton Planin e Veprimit për vitin 2013



Ekuilibri i së keqës falë lakmitarëve

Të Nderuar lexues,

Në rrethanat në të cilat sot jetohej në Kosovë, që nuk janë aspak të mira dhe shpresëdhënëse, përfaqësimi institucional i duhur është vështirë të kryhet me sukses. Në rrethanat kur sistemi demokratik në shoqëri vetëm është i shkruar dhe i pa zbatuar dhe funksionaliteti i institucioneve është larg standardeve, atëherë përfaqësuesi i ndershëm i popullit në këto institucione është vështirë të mbetet i suksesshëm. Por të jesh përfaqësues i një komuniteti relativisht të vogël, me halle jo të vogla, me shumë pak vetëdije kombëtare, me organizim të brishtë, me kërkesa të mëdha për përfitime personale dhe me veçori tjera të veçanta por të zakonshme në Ballkan, atëherë edhe më vështirë është të jesh i suksesshëm. Është evidente shumë pakënaqësia në përgjithësi te populli i Kosovës me pushtetarët dhe me përfaqësuesit pa dallim se çfarë pozitash mbajnë ata ose ato, dhe për këtë nuk kanë faj por ajo e keqe që është instaluar te pushteti, ajo nuk ka mbetur pa depërtuar në formë të hijes së pushtetit edhe në pjesën më të madhe të popullit duke u manifestuar me lakmi për përfitim personal nga ky pushtet i stërkequr. Nëse pushteti e ka instaluar korrupsionin, krimin e organizuar, ka degraduar shkollat dhe shëndetësinë, nuk e ka idenë dhe nuk humb kohë që të gjejë mënyra se si të ketë zhvillim ekonomik, të ketë vende të reja të punës dhe pastaj edhe të rritet cilësia e të jetuarit të qytetarit të Kosovës.

Ky refren që përsëritet vazhdimisht, për qytetarin e Kosovës është bërë rutinë që i dëgjon për çdo ditë dhe natë në televizor, bile nëse ndodh që këto mos të përmenden në televizor, ai mundet të çuditet. Pjesa më e madhe e qytetarëve në Kosovë kanë ankesa për qeverinë, për parlamentin, për komunën, dhe po këta gjejnë lidhje për me regjistru djalë ose vajzë në mjekësi, për me regjistru djalë ose vajzë në gjimnaz, me punësi djalë ose vajzë, me gjet lidhje për me përfitua donacion për bujqësi pa i plotësua kriteret, me përfitu ndonjë subvencion për shërim pa qenë i sëmur, me përfitu një shtëpi se nuk po e qon mirë me djalë etj etj. Pra këtë gjendje po e mbajnë të ekuilibruar vetë njerëzit lakmitar që nuk mërzhiten hiq nëse me veprimet e tyre po i forcojnë rrënjët së keqës. Nëse qytetarët do t'i tejkalonin lakminë dhe do të kërkonin përgjegjësi atëherë e keqja e instaluar do të luhatej dhe nuk do të kishte ku të mbështetet.

Përfaqësuesit e zgjedhur të komunitetit egjiptian e kanë vështirë që hallet dhe problemet e popullit të tyre t'i zgjedhin edhe sikur të ishin institucionet funksionale dhe demokratike, për shkak se jemi një komunitet relativisht i vogël dhe me halle relativisht të mëdha, për shkak të paragjytimeve ndaj komunitetit tonë nga ana e komunitetit shumicë por edhe te bartësit e institucioneve, për shkak të sjelljes servile të një pjese të madhe të komunitetit tonë ndaj shumicës. Pjesëtarët e komunitetit tonë duhet të dinë se nuk ka 5% ose 10% buxhet për ne, dhe kinse përfaqësuesit e tyre janë të paafte që t'i dedikojnë atë buxhet për komunitetin; duhet të dinë se përfaqësuesit e tyre nuk mund të zbresin kuotat e kriterëve qoftë për pagesë të udhëtimit të fëmijëve, qoftë për regjistrim të fëmijëve, qoftë për regjistrimin e nxënësve ose studentëve, qoftë për përfitimin e lopëve, traktorëve, tertaqave, qoftë për ndërtimin e shtëpive etj. Vlerësimi te pjesëtarët e egjiptianëve se "unë sta pava hajrin se nuk m'ke dhanë kurgja" është shumë e shprehur dhe ky mentalitet është pjesë e mentalitetit të një shumice të qytetarëve në Kosovë të cilët të verbëruar pas lakmisë po e mbajnë të ekuilibruar të keqen e instaluar në Kosovë.

24 Qershori “Dita e Egjiptianëve” në Kosovë

Me datën 27 Dhjetor 2012, në takimin e përbashkët për caktimin e Ditës së Egjiptianëve në Kosovë, me konsensus të plotë është vendosur që Dita e Egjiptianëve në Kosovë të jetë 24 Qershori. Në këtë takim, të organizuar nga IRDK dhe i mbështetur nga organizatat e Egjiptianëve në Gjermani, Zvicër dhe Austri, kanë marrë pjesë përfaqësuesit politik, të shoqërisë civile, të rajonit dhe përfaqësuesit nga diaspora. Në këtë takim kanë marrë pjesë kryetari i IRDK, kryetari i LEK në Kosovë, sekretari i UEB, përfaqësuesit nga Gjermani, Zvicra dhe Austria si dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile.



Hapja e takimit nga ana e kryesuesit

Takimi është kryesuar nga Fazli Stollaj, dhe është hapur me këto fjalë: "Të punosh me urtësi është vlerë që reflektohet menjëherë dhe në veçanti vlerësohet nga ata që vijnë pas neve. Ekziston një shtytje që buron në shpirtrat tonë që të marrim Përgjegjësitë për fatin tonë, dhe ajo shtytje vjen natyrshëm nga para ardhësit tonë që punuan me urtësi për fatin tonë. Neve të gjithëve na bënë të fortë entuziazmi, guximi, sakrifica e të gjithë pishtarëve që ndezën dritat e fatit tonë, e filluan betejën për kthimin e krenarisë sonë, të ndriçimit të identitetit tonë. Të kujtosh ngjarje të rëndësishme për popullin tonë do të thotë të ngritsh krenarinë dhe të ndihesh me vlera. Të kujtosh ngjarje të rëndësishme në mënyrë periodike, për çdo vit, do të thotë të rritsh krenarinë tende për çdo vit. Të vendoset nga të gjithë ne se cila është ngjarja që do të na bëjë të ndihemi

krenar do të thotë se kemi treguar urtësi dhe kjo urtësi e treguar nga të gjithë ne që jemi mbledhur sot këtu do të shndërrohet në energji të gjeneratat që vijnë pas neve dhe në këtë mënyrë dinjiteti do të jetë i sigurt. Sot jemi mbledhur këtu të gjithë së bashku për të vendosur se cilën ngjarje të rëndësishme do ta kujtojmë për çdo vit. Sot në këtë takim me dëshirë të madhe kanë ardhur njerëz nga Gjermani, Zvicra, Austria, Maqedonia të cilët kanë udhëtuar në kushte të vështira dhe me pa durim presin që në vitin 2013 të festojnë ditën që do të caktojmë sot."

Përshëndetja e takimit



Xhevdet Neziraj, në emër të IRDK-së e ka vlerësuar shumë mbajtjen e takimit dhe pjesëmarrjen e gjerë dhe ndër të tjera ka theksuar se Ditën që do të caktojmë ne sot do të jetë ditë që do të na bashkon të gjithë neve dhe jam i sigurt se sot nuk do të ketë humbës por të gjithë do të jemi fitues pasi që për këtë ditë po vendosim të gjithë së bashku.



Bislim Hoti, në emër të LEK-Kosovë gjithashtu e ka vlerësuar mbajtjen e takimit dhe ndër të tjera ka theksuar se ne duhet të kemi shumë kujdes se çfarë dite po caktojmë pasi që ne e dimë se nuk kemi bërë luftë dhe korrur fitore prandaj nëse ne sot nuk arrijmë që të vendosim me konsensus atëherë le të formohet një komision i cili do ti shqyrtoj propozimet tona dhe në mënyrë profesionale le të vendos për këtë datë.



Prof. Dr. Rubin Zemon, në emër të UBE e ka vlerësuar mënyrën demokratike të caktimit të ditës së Egjiptianëve dhe ka theksuar se të gjithë Egjiptianët e Ballkanit duhet të marrin model nga ju për vendimmarrje demokratike për çështje të rëndësishme.

24 Qershori “Dita e Egjiptianëve” në Kosovë

Milazim Alijaj, në emër të diasporës në Gjermani e ka përshëndetur takimin dhe ka falënderuar organizatorët t takimit. Ai gjithashtu ka potencuar si shumë të rëndësishme që edhe Egjiptianët në Kosovë të kenë Ditën e tyre.



Bajram Imeraj, në emër të diasporës në Zvicër, duke iu referuar nismëtarit të çështjes së Egjiptianëve, Nazmi Arifi, i cili thoshte se ne jemi duke u ringjallur, ai tha se edhe sot është një ditë e madhe ku ne po ringjallemi.



Sedadine Delija, në emër të diasporës nga Austria e vlerësoj mbajtjen e takimit dhe ndër të tjera theksoi se kjo ditë është dashur të caktohet më herët por sot është një ditë e madhe për Egjiptianët në Ballkan.



Armend Behluli, në emër të shoqërisë civile në Kosovë e vlerësoj si të qëlluar mbajtjen e takimit dhe ndër të tjera theksoj se kjo ngjarje bashkë me iniciativën për biseda me ashkalitë janë dy ngjarje më të rëndësishme.



Imer Alijaj, në emër të Forumit të Egjiptianëve të Kosovës theksoj se kjo është një ditë e madhe ku kemi arrit që të mblidhemi së bashku dhe gjithashtu bashkë të caktojmë Ditën tonë që do të na bashkoj të gjithëve.



Propozimet për “Ditën e Egjiptianëve” në Kosovë

Xhevdet Neziraj, në emër të IRDK-së paraqiti qëndrimin e Kryesisë së IRDK-së lidhur me Ditën e Egjiptianëve në Kosovë. Ai theksoi se propozimi i IRDK është që 24 Qershori të jetë Dita e Egjiptianëve në Kosovë.

Bislim Hoti, në emër të LEK-Kosovë theksoj se ne kemi dy propozime: 21 Tetori dita kur është themeluar Shoqata e Egjiptianëve në Kosovë dhe 24 Qershori, dita kur është mbajtur Kuvendi i Ohrit.

Milazim Alijaj, në emër të diasporës në Gjermani theksoi se kemi shumë data të rëndësishme që pa dyshim mund të jenë Dita e Egjiptianëve por ne propozojmë që Dita e Egjiptianëve të jetë 24 Qershori ose 21 Tetori. 24 Qershori është fillimi i aktiviteteve të para dhe kjo datë do të jetë e pranueshme për të gjithë Egjiptinët në Ballkan dhe 21 Tetori dita kur është themeluar shoqata e Egjiptianëve në Kosovë. Për shkak se ishte paralajmëruar nga deputeti Xhevdet Neziraj që dita e Egjiptianëve të përcaktohej brenda një afati të shkurtër ne ishim mbledhur në Gjermani dhe kishim propozuar 21 Tetorin si ditë e Egjiptianëve por pa asnjë dyshim e mbështesim që 24 Qershori të jetë Dita e Egjiptianëve në Kosovë.

Bajram Imeraj, në emër të diasporës në Zvicër, propozojmë që 24 Qershori të jetë Dita e Egjiptianëve në Kosovë. Ne kishim marrë një qëndrim në Zvicër që Dita e Egjiptianëve të jetë data e themelimit të Shoqatës Shqiptaro Egjiptiane por dje kishim një takim të përbashkët lidhur me harmonizimin e qëndrimeve prandaj edhe ne mbështesim pa rezervë që 24 Qershori të jetë Dita e Egjiptianëve në Kosovë.

Sedadine Delija, në emër të diasporës nga Austria e mbështeti propozimin 24 Qershori nga parafolësit.

Armend Behluli, në emër të shoqërisë civile në Kosovë e mbështeti propozimin që 24 Qershori të jetë Dita e Egjiptianëve në Kosovë.

24 Qershori “Dita e Egjiptianëve” në Kosovë

Kontributi i përfaqësuesit nga Maqedonia

Dr. Rubin Zemon, përfaqësues i Unionit të Egjiptianëve të Ballkanit në mënyrë kronologjike paraqiti fakte historike lidhur me identitetin e Egjiptianëve të Ballkanit. Ai potencoj argumente gjatë sundimit të Perandorisë Osmane në Ballkan ku administrata e Perandorisë Osmane kishte nxjerrë vendime të veçanta për romët dhe egjiptianët. Ai gjithashtu përmendi ngjarjet në Luftërat Ballkanike ku Egjiptianët u ndanë në disa shtete, fakte të vitit 1945 lidhur me kërkesën e Egjiptianëve në Shqipëri drejtuar Enver Hoxhës që të njihej pakica e Egjiptianëve në Ballkan, gojëdhënat gjatë viteve 50 dhe 60 lidhur me regjistrimet për migrim në Egjipt. Ai theksoj se fat i keq ishte viti 1971 kur u bënë përpjekje që shumë popuj përfshirë edhe egjiptianët të futen brenda termit rom. z. Zemon përmendi përpjekjet për regjistrim si toskan gjatë regjistrimit të popullsisë në vitin 1971 në disa vende të Maqedonisë, regjistrimin si egjiptian gjatë regjistrimit të vitit 1981 dhe Kuvendin në Ohër me 24 Qershor të vitit 1990 kur ishte vendosur që të veprohej intensivisht që në regjistrimin e vitit 1991 të ekzistonin grafe edhe për Egjiptian, ku edhe ashtu ndodhi, pra në vitin 1991 u regjistruan disa mijëra Egjiptian. Ai përmendi edhe momente të rëndësishme pas vitit 1990, siç është formimi i shoqatës së Egjiptianëve në Kosovë, krijimi i shoqatës dhe IRDK pas vitit 1999 si dhe futja në kushtetutën e Kosovës.

Debat mbi përcaktimin e "Ditës së Egjiptianëve" në Kosovë

Nga propozimet e përfaqësuesve të subjekteve politike, të shoqërisë civile dhe diasporës ishte arritur konsensusi që 24 Qershori të jetë "Dita e Egjiptianëve" në Kosovë, prandaj nuk pati debat lidhur me propozimet por hetohej vetë gëzimi dhe emocionet nga të pranishmit.

Nënshkrimi i Deklaratës mbi përcaktimit të "Ditës së Egjiptianëve" në Kosovë

Kryesuesi lexoj dhe prezantoi në ekran deklaratën përmes së cilës përcaktohet "Dita e Egjiptianëve" në Kosovë.



Xhevdet Neziraj



Bislim Hoti



Gazmend Dervishi



Rubin Zemon



Milazim Alijaj



Bajram Imeraj



Xhevdet Gavrani



Sadri Alaj



Armend Behluli



Fazli Stollaj



Nevruz Tafoshi



Ramadan Hasani

24 Qershori “Dita e Egjiptianëve” në Kosovë



Elbert Krasniqi



Jahir Zymeraj



Mirjeta Gecaj



Imer Zykollaj



Bedri Mustafa



Besnik Luboja



Ukë Dollci



Imer Alijaj



Mesazh i kryetarit të IRDK-së lidhur me “Ditën e Egjiptianëve” në Kosovë



Sot me datën 27 Dhjetor 2012 të gjithë së bashku kemi vendosur për një ngjarje të rëndësishme të Historisë së Egjiptianëve në Kosovë. Është 24 Qershori Dita e Egjiptianëve në Kosovë që do të na bashkojë të gjithëve në një sofër të

Xhevdet Neziraj përbashkët, në të cilën datë do të kujtojmë të ngjarjen shumë të rëndësishme të para ardhësve tonë që vendosen platformën për krijimin e formave të organizuara të Egjiptianëve në Ballkan. Me 24 Qershor 1990 është mbajtur Kuvendi i Ohrit në Maqedoni dhe pishtarët që morën pjesë në këtë Kuvend ndezën dritën e fatit tonë, dhe filloj procesi i qartësimit të identitetit tonë. Kemi fatin e mirë që për këtë Ditë të Madhe u përcaktua të gjithë së bashku dhe në këtë Ditë të Madhe do të Festojmë edhe në Kosovë edhe në Shqipëri edhe në Maqedoni dhe në vise tjera të Ballkanit. Sot të gjithë së bashku kemi treguar përgjegjësi dhe pjekuri para qytetarëve tonë prandaj Ju Uroj shumë për këtë Ditë dhe me 24 Qershor do të festojmë të gjithë së bashku. Urime dhe Gëzuar.

Kryetari Xhevdet Neziraj uron Vitin e Ri

Në emër të IRDK iu dëshiroj shëndet, paqe, lumturi, harmoni dhe urime për vitin 2013. Viti që shkoi ishte edhe një vit me angazhime ku vendosmëria jonë për arritjen e qëllimeve dhe objektivave tona nuk është zbehur e as lëkundur. Edhe gjatë këtij viti që po përfundon përmes përfaqësimit institucional, kemi arritur për të ngritur çështjet të caktuara dhe kemi këmbëngulur për realizimin e tyre. Gjatë këtij viti kishim dy momente të

rëndësishme. Momenti i parë i rëndësishëm ishte vendimi i Këshillit Drejtues të IRDK-së për fillimin e bisedimeve për zgjidhjen e çështjeve kontestuese në mes të Egjiptianëve dhe Ashkalive dhe momenti tjetër u shënua me 27 Dhjetor të këtij viti kur me pjekuri të duhur të të gjithëve përfshirë subjektet politike, shoqërinë civile dhe diasporën, përcaktuam 24 Qershorin Ditë të Egjiptianëve në Kosovë. Edhe pse procesi i bisedimeve me ashkalitë nuk po ecë me ritmin që IRDK dëshiron, mbetemi me shpresë të madhe që në vitin 2013 të shënojmë hapa konkret lidhur me përafrimin e popullit tonë. Fakti se IRDK konsideron që në Egjiptianët dhe Ashkalitë jemi i njëjti popull por kemi dallime rajonale dhe për teke të individëve të caktuar kjo ndarje ende po na sundon, ofrimi dhe zgjidhja e kontesteve do të ndodh dhe askush nuk mund ta pengoj për shkak se nuk ka asnjë arsye që të vazhdojmë të mbesim të ndarë. Gjatë këtij viti kishim kontakte me përfaqësues nga shteti i Egjiptit të cilat kontakte vazhdojmë t'i mbajmë dhe presim stabilizimin e situatës në këtë shtet dhe vendosjen e lidhjeve diplomatike të Kosovës dhe Egjiptit. Gjithashtu edhe gjatë këtij viti IRDK me këmbëngulësi e ka kritikuar dhe kundërshtuar përdorimin e termit RAE nga institucionet e Kosovës dhe sidomos nga OJQ. Reformimi dhe fuqizimi i IRDK-së do të ndodh gjatë vitit 2013 dhe për këtë arsye i ftoj të gjithë ata që kanë vullnet dhe dëshirë që të kontribuojnë për të mirën e popullit tonë le të marrin përgjegjësi në strukturat e IRDK-së. Në këtë fund viti sinjerisht i përshëndes bashkëkombësit tonë në mërgatë, në Gjermani dhe Zvicër dhe në vende tjera dhe i ftoj që të gjejnë fuqi dhe guxim që të organizohen më mirë në mënyrë që të kenë pozitë më të mirë në vendet ku jetojnë dhe të ndihmojnë njerëzit e tyre në Kosovë.

Duke ju përshëndetur përzemërsisht, në vitin 2013 iu dëshiroj për një vit të mbarë, me lumturi, paqe dhe harmoni.

Takimet e kryetarit Xhevdet Neziraj

Kryetari i IRDK-së merrë pjesë në pritje të delegacionit të Lartë nga Egjipti



Me datën 14.11.2012, me ftesë të kryetarit të Parlamentit të Kosovës z.Jakup Krasniqi, është pritur delegacioni i Dhomës së Lartë të Egjiptit (Këshilli Shura) i udhëhequr nga kryetari z.Ahmed Fahmy Ahmed. Në pritje të delegacionit nga Egjipti, në cilësinë e përfaqësuesit të Egjiptianëve të Kosovës, është ftuar kryetari i IRDK-së Xhevdet Neziraj. Vizita është realizuar në kuadër të përpjekjeve të autoriteteve të Kosovës për njohjen e Kosovës nga ana e Egjiptit. Në këtë rast kryetari Xhevdet Neziraj ka shfrytëzuar rastin për njohjen e këtij delegacioni lidhur me prezencën e Egjiptianëve në Kosovë dhe për pozitën e tyre. Xhevdet Neziraj ka shprehur nevojën e njohjes së Kosovës nga ana e Egjiptit dhe vendosjen e marrëdhënieve me shtetin e Egjiptit. Ai ndër të tjera ka theksuar se njohjes së Kosovës nga ana e Egjiptit përpos 2 milion shqiptareve do ti gëzohen edhe disa mijera Egjiptian të Kosovës. Ai gjithashtu e ka njoftuar mysafiret për kontributin e Egjiptianëve të Kosovës për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Kryetari Xhevdet Neziraj ka marrë pjesë edhe në darkën e shtruar për mysafirët dhe ka zhvilluar biseda me të zgjeruara me mysafirët Egjiptian. Anëtarët nga delegacioni i Egjiptit kanë marrë informacione më të hollësishme lidhur me Egjiptianet e Kosovës.

Kryetari Xhevdet Neziraj takohet me Samuel Zhbogar

Me datën 24 Janar 2013, kryetari i IRDK z.Xhevdet Neziraj është takuar me përfaqësuesin e Bashkimit Evropian në Kosovë z.Samuel Zhbogar. Në këtë takim kryetari i IRDK-së ka paraqitur sfidat e komunitetit Egjiptian në Kosovë dhe vizionin e IRDK-së për zgjidhjen e këtyre sfidave. Kryetari Xhevdet Neziraj ka potencuar arsyet e kundërshtimit të IRDK-së të strategjisë për integrimin e komuniteteve RAE duke e përmendur organizimin e javës së Komuniteteve RAE dhe në veçanti organizimin e koncertit me muzikë romë ku BE ishte sponzor i këtij aktiviteti dhe z.Zhbogar ishte i pranishëm në këtë takim. Edhe unë do të merrja pjesë në këtë koncert si deputeti i Parlamentit të Kosovës po të isha i ftuar në një koncert të romëve por në asnjë mënyrë nuk do të marrë pjesë në një koncert romë që thirret si koncert i komunitetit RAE theksoi kryetari Xhevdet Neziraj. Kryetari Neziraj potencoi faktin e ndërmarrjeve publike në Kosovë ku asnjë pjesëtar i komunitetit egjiptian nuk është i punësuar, nevojën e realizimit të projekteve të infrastrukturës, menaxhimit e duhur të fondeve të Këshillit të Evropës dhe çështje tjera që preokupojnë komunitetin egjiptian në Kosovë.

Nga ana tjetër z.Samuel Zhbogar shprehu gadishmerinë e tij që të ndihmojë në tejkalimin e të gjitha sfidave që u paraqiten dhe premtoj bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit politik të komunitetit egjiptian në Kosovë. Ai theksoi se në çdo moment do të jep kontributin e tij lidhur me zgjidhjen e problemeve të potencuara.

Vazhdimi i kaosit te Egjiptianet dhe Ashkalitë, rezultat i paaftësisë për të trajtuar drejt problemin



Trajtimi si çështje dytësore i inicimit të bisedave në mes bashkësisë së njëjtë etnike e tash e dymbëdhjetë vjet të ndarë me emërtime të ndryshme, Egjiptian e Ashkali, është naive dhe s'ka të bëjë as

Fazli Stollaj me ndjenjën kombëtare e as me përmirësimin e pozitës së komunitetit. Nëse dikush mendon se fati i identifikimit tonë etnik është vulos dhe ne përfundimisht kemi përfunduar të ndarë në Egjiptian dhe Ashkali atëherë ata gabojnë për shkak se ka njerëz që nuk do ta lejojnë këtë hile që është futur tek ne dhe zgjidhja do të ndodh shumë shpejt. Deklarata publike e Këshillit Drejtues të IRDK që bënë thirrje për bisedime pa asnjë kusht për çështjet kontestuese në mes Egjiptianeve dhe Ashkalive, deri me tani nuk është dëgjuar nga askush. Kjo nuk është mirë për shkak se këtë nuk e ka bërë IRDK vetëm për të përfituar poena politik por kjo është esenciale nëse dëshirojmë që të jemi të zot e vetvetes. Të gjitha lëvizjet që filluan, qofshin ato para vitit 1999 dhe ato pas këtij viti, me përjashtim të disa OJQ-ve të cilat formohen e veprojnë edhe sot e për çdo ditë për interesa individuale, kishin për synim që edhe ne si një grup etnik i veçantë që ishim të përmbajtur dhe pa ndonjë qartësi të duhur për vetveten, t'i qartësojmë çështjen e gjenezës sonë dhe të ndihemi krenar për etninë tonë. Po të mos ishte kjo çështje shumë njerëz që u angazhuan në këto lëvizje, përfshirë edhe mua, nuk do të rreshtoheshin për të bërë karrierë politike. Kaosi që e përfshiu komunitetin tonë në vitin 1999 u përmblodh me paraqitje të etnive të reja dhe ky kaos nuk është shuar vetëm se është institucionalizuar. Nuk din askush të na bije në fije prandaj na pikëzuan RAE dhe shumë kush po e merr këtë punë si të kryer, duke mos e lodh kryet hiq dhe duke e harruar faktin se RAE do të thotë rom. RAE e ka vërshtuar edhe institucionet vendore edhe ndërkombëtare por edhe në shtetet e regjionit. Të deklarohesh RAE do të thotë se ti je edhe rom edhe ashkali edhe egjiptian ndërsa

pretendon se piramidat e Egjiptit janë vlerat kulturore të paraardhësve të tu ose se je nipi i Hashkanit që s'dinë kurrkush me tregu për atë punë. Kjo është tmerr. Edhe egjiptianet edhe ashkalitë me naivitetin e tyre janë duke e mbajtur frymën rome në Kosovë për shkak se në Kosovë nuk ka romë. Në Prishtinë që ka pasur po thuhet më së shumti romë nuk është asnjë, në Mitrovicë ka shumë pak, në Ferizaj gjithashtu ka shumë pakë edhe në Pejë e Gjakovë janë një grusht i romëve. Prandaj të merresh me çështjen e kaosit të institucionalizuar dhe të merresh me parandalimin e shkrirjes sonë në të ardhmen në romë nuk është hiq çështje dytësore. Çështja për tu zgjidhur është shumë e thjeshtë por shumë e rëndësishme që të zgjidhet. Nëse pajtohemi se Egjiptianet dhe Ashkalitë janë grupi etnik i njëjtë atëherë problemi është zgjidhur dhe nëse këtu kemi dilema atëherë problemi nuk ekziston. Nëse dilema nuk ka atëherë grupi etnik i njëjtë i ndarë në emërtime ekziston për shkak të pa aftësisë sonë që të ndalemi pak dhe me qetësi të mendojmë se pse nuk ulemi së bashku, të bisedojmë dhe të shohim se cilat janë problemet. Mbetja në këtë gjendje nuk ka dyshim se është rezultat i mungesës së të paktën një individi ose grupi vullnet mirë që do të iniciohte dhe të adresonte drejt këtë çështje. Nëse ekzistojnë njerëz të mençur nga ana e ashkalive dhe egjiptianeve atëherë problemi është shumë i thjeshtë për t'u zgjidhur. Në periudhën e fundit, Egjiptianet kanë filluar të deklarohen publikisht në fillim të viteve '90 me emërtimin që tregon gjenezën e tyre ndërsa ashkalitë filluan të deklarohen publikisht në vitin 1999 me emërtimin lokal si e kishin quajtur vetveten në rrafshin e Kosovës. Egjiptianet e ashkalitë asnjëherë nuk kanë luftuar në mes veti, as nuk janë përleshur në mes veti, as nuk janë distancuar nga njeri tjetri por vetëm udhëheqësit e tyre nuk janë treguar të mençur dhe janë futur aventura për shkak të papjekurisë së tyre dhe për shkak të interesave personale. Përkundër distancës së vendosur nga udhëheqësit e egjiptianeve dhe ashkalive, jeta e komunitetit është e përbashkët, ata vazhdojnë të martohen në mes veti pa asnjë

problem, ata vazhdojnë të kenë lidhje familjare pa asnjë problem, ata vazhdojnë të ndajnë të mirën dhe të keqen në mes veti pa asnjë problem. Nëse themi se kështu është mirë ne po vazhdojmë si egjiptian dhe ata le të vazhdojnë si ashkali atëherë nuk është në rregull. Fati i egjiptianeve dhe ashkalive është i përbashkët. Nëse nuk jemi një atëherë nuk do të ketë as egjiptian e as ashkali por do të ketë vetëm romë, nëse do të jemi një do të jemi bashkësi etnike e respektuar me potenciale për të kërkuar dhe realizuar të drejtat tona të cunguara. Iniciativa për bisedime e përgatitur si asnjëherë më parë, duke e hartuar një dokument të njohur si platforma për bisedime dhe duke e emëruar ekipin për bisedime duhet mbështetur nga të gjithë për shkak se kjo është një çështje e rëndësishme nacionale dhe në asnjë mënyrë nuk duhet marrë me dyshime. Nëse e merr përsipër dikush tjetër që të udhëheqë këtë çështje, siç është Unioni i Egjiptianeve të Ballkanit ose Forumi i Egjiptianeve të Kosovës ose cilido asociacion serioz jo politik i Egjiptianeve ose Ashkalive atëherë do të ishte më se miri edhe për IRDK-në dhe IRDK do të ndihmojë këtë çështje me të gjitha kapacitetet që i ka. Por nëse dikush për interesa personale vazhdon të bllokojë ose zvarrisë fillimin e bisedimeve dhe pretendon se fati i identifikimit tonë etnik është vulos dhe ne përfundimisht kemi përfunduar të ndarë në Egjiptian dhe Ashkali, atëherë ata gabojnë për shkak se ka njerëz që nuk do ta lejojnë këtë hile që është futur tek ne dhe zgjidhja do të ndodh shumë shpejt.

Në pritje me pak shpresë

Si duket pozicionet e popullit tonë të pas luftës në blloqet Egjiptian dhe Ashkali janë betonuar dhe vështirë të lëvizin në drejtim ku e kanë vendin. Kjo po ndodh për shkak se liderët e popullit që kanë marrë përgjegjësi të prezantojnë në institucione dhe të mbrojnë dhe promovojnë interesat e popullit e kanë gjetur strofullat në këto pozicione dhe kanë dëshirë të madhe që gjithmonë të mbesin aty të fortë dhe gjejnë mundësi që të mundin njëri tjetrin me "argumente". Përpjekjet që me "argumente" të mundin njëri tjetrin duke mos hezituuar shpesh që të lansojnë dezinformata dhe shantazhojnë personalitete është bërë dukuri e blloqeve Egjiptian - Ashkali.

Ne kemi ngecur në bisedimet që kishim filluar të planifikojmë që të zhvillohen. Më duhet të them përsëri se ska asgjë më të rëndësishme edhe për Egjiptianet edhe për Ashkalitë që të fillojnë të bisedojnë dhe ti zgjidhin të gjitha çështjet që po na mbajnë të ndarë. Edhe Egjiptianet edhe Ashkalitë e kanë krijuar një identitet i cili është mjaftë fiktiv por i pa mohueshëm. Ne duhet të largohemi nga prirjet për të mohuar njeri tjetrin, pra ne duhet sot të pranojmë se formalisht jemi të ndarë por ndarja është shumë artificiale dhe nuk duhet të pranojmë që të jetë edhe në realitet. Njerëz të caktuar edhe mund të krenohen me këtë ndarje, edhe mund ti akuzojnë të tjerët për tradhti por gjeneratat e ardhshme do të shohin me lehtësi se këta njerëz kanë qenë pa dije, pa karakter dhe i kanë shërbyer egos së tyre. Përderisa ne nuk jemi në gjendje që të fillojmë të bisedojmë dhe gradualisht të ofrohem me njeri tjetrin përmes krijimit të mekanizmave të përbashkëta, përderisa ne nuk kemi aftësi ti shtrojmë problemet dhe ti zgjedhim ato, as Egjiptianet e as Ashkalitë nuk kanë identitet por do të mbetemi pa identitet të qartë dhe gjithmonë do të mbetemi të marginalizuar. Mos afrimi i Egjiptianeve dhe Ashkalive për shkak të egove të personave dhe grupeve të caktuara është e pa pranueshme dhe nëse ne nuk iu përgjigjemi këtyre personave dhe grupeve atëherë hija e tyre do të mbajë të robëruar njerëzit e pafajshëm. Unë kam shumë besim tek personaliteti i disa njerëzve nga ana e bllokut të ashkalive që e kanë kuptuar drejt çështjen dhe rëndësinë e fillimit të bisedimeve por njëkohësisht kërkohet guxim për të filluar procesin sepse nuk guxojmë të mbetemi të robëruar nën hijen e egoisteve naiv. Deri më tani nuk kanë lëvizur gurët nga pozicionet e betonuara dhe vetëm urtësia e njerëzve të sinqertë dhe largpamës do të vlerësojë drejtë rëndësinë për të qenë bashkë Egjiptianët dhe Ashkalitë dhe vetëm atëherë do të shohin të gjithë se sa të parëndësishme janë ideologjitë dhe egot e themeluesve të kombeve. Atyre që nuk dëshirojnë të bisedojnë për ofrimin e Egjiptianëve dhe Ashkalive, atyre që me pa dijen dhe cinizmin e tyre shkruajnë libra me pendën e zjarrit dhe mendojnë të vendosin mur në mes të Egjiptianëve dhe Ashkalive, atyre që me pseudo shkrime etiketojnë njërin ose tjetrin bllok, atyre që ndihen komod me këtë ndarje dhe nuk qajnë hallin e të ardhmes duhet t'ju thuhet qartë se duhet të ktheheni nga ëndrrat dhe të shkëlqin në realitet ose ikni se ka kush të merret me fatin tonë.



Xhevdet Neziraj

Çka tha kryetari Xhevdet Neziraj në Parlamentin e Kosovës

Në vijim janë shënuar fjalët e kryetarit të IRDK-së Xhevdet Neziraj në seancën Plenare të Parlamentit të Kosovës të mbajtur me datën 21 Shkurt 2013.

Faleminderit, i nderur zoti kryetar! Ministra, Kolegë deputetë. Do të ngre një shqetësim në lidhje me Raportin e fundit të UNDP-ës dhe të Human Rights Watch, ku në raportin e shkallës së papunësisë, përveç një numri të madh të shumicës së kosovare e cek edhe një raport shumë shqetësues se 3/4 e komunitetit egjiptian janë të papunë dhe sidomos të papunësuar në institucionet shtetërore. Do të thotë ky është një shqetësim që jam duke e ngritur që shumë herë dhe raportet e tilla për çdo vit janë të këqija e më të këqija.

Përveç këtij raporti, është edhe raporti të cilin vet e jep institucioni – Avokati i Popullit, pastaj Ministria për Komunitete e Kthim, Zyra për Komunitete e Kryeministrit dhe është shumë absurde se mu këto institucione që duhet të merren me mbrojtjen e komuniteteve, nuk kanë asnjë pjesëtar të komunitetit egjiptian të punësuar, ndërsa e ngritën çështjen për shkallë të lartë të papunësisë. Prandaj, nga ky vend, nga ky institucion bëj thirrje që në radhë të parë institucionet që janë të thirrur për t'i mbrojtur komunitetet së pari ato duhet t'i respektojnë. Së pari Avokati i Popullit duhet të ketë vend edhe për pjesëtarë të komunitetit egjiptian.

Gjithashtu Zyra e Kryeministrit duhet të ketë vend për pjesëtarë të komunitetit egjiptian. Gjithashtu edhe institucionet tjera e ndërmarrjet publike që i kanë 10% kuotën e caktuar me ligj duhet këto ta respektojnë. Nuk është filozofi që të punosh në KEK, që ta lexosh një njehsor ore, bile do ta lexojnë më mirë se ata që muajin e kaluar kanë bërë gabime, për t'u punësuar në KEK ose në PTK, ose në shumë ndërmarrje tjera. Unë do ta ngre edhe një

çështje tjetër, se edhe institucionet vitale të shtetit, siç janë: Policia, Dogana, Administrata Tatimore, nuk e kanë asnjë pjesëtarë të komunitetit egjiptian të punësuar. Atëherë, mund të themi se kësaj nuk i thonë diçka tjetër vetëm një diskriminim i cili duhet të ndalet dhe në vend që të ketë fjalime të mëdha, por besoj se duhet të ketë veprime të mëdha dhe duhet t'u ndihmohet atyre komuniteteve që me vite kanë qenë të shkelur, me vite kanë qenë të marginalizuar dhe me vite kanë qenë të diskriminuar. Ju faleminderit.

Takimi i degës së IRDK-së në Istog



Pamje nga takimi në degën e Istogut

Me datën 23 shkurt 2013, Kryesia e degës së IRDK-së në Istog ka mbajtur një takim të zgjeruar me anëtarët e Kryesisë së kësaj dege dhe me anëtarë tjerë të IRDK-së nga komuna e Istogut. Në këtë takim ka marrë pjesë edhe kryetari i IRDK-së Xhevdet Neziraj. Takimin e ka hapur kryetari i degës së IRDK-së në Istog Fazli Stollaj, i cili fillimisht i ka përshëndetur të pranishmit dhe shkurtimisht i ka njoftuar lidhur me zhvillimet e fundit në nivel të organeve qendrore të partisë dhe me disa zhvillime të rëndësishme që kanë ndodhur në periudhën e fundit. Ai, si ngjarje të rëndësishme përmendi vendimin e Kuvendit të Përgjithshëm të IRDK-së për hartimin e platformës për bisedime me ashkalitë, pastaj hartimin nga grupi punues i platformës dhe miratimi i saj nga ana e Këshillit Drejtues dhe kontaktet e para për fillimin e bisedimeve. Në këtë

kontest ai përmendi takimet e zhvilluara me dy partitë e ashkalive si dhe takime tjera. Ai përmendi faktin e unifikimit të faktorit politik dhe të shoqërisë civile nga ana e egjiptianëve lidhur me bisedimet e propozuara, marrëveshjen për strukturimin e bisedimeve dhe faktin e refuzimit nga ana e ashkalive që të nënshkruajnë një marrëveshje për të biseduar dhe për të zgjedhur të gjitha çështjet që janë kontestuese. Nëse vazhdohet nga ana e ashkalive që të na refuzojnë për të biseduar për çështjet që na ndajnë, theksoi ai, atëherë me këto veprime ashkalitë janë duke rrëshqitur në romë. Ai gjithashtu theksoi se ka besim të disa njerëz të vetëdijshëm dhe të përgjegjshëm nga ana e ashkalive që shumë shpejtë do të fillojnë që të bashkëpunojnë me ne dhe të fillojnë një proces të bashkimit dhe të kërkimit të pozitës më të mirë së bashku në shoqërinë kosovare. Kryetari i degës së IRDK-së në Istog i cili është edhe kryesues i Këshillit Drejtues të IRDK-së dhe anëtar i Kryesisë së IRDK-së përmendi edhe takimin e 27 Dhjetorit ku janë treguar të përgjegjshëm spektri politik dhe shoqëria civile dhe së bashku kanë përcaktuar Ditën e Egjiptianëve të Kosovës, pra edhe ne në Istog me 24 Qershor do të festojmë ditën tonë, theksoi ai. Ai përmendi edhe miratimin e Planit të veprimit nga ana e Kryesisë së IRDK-së dhe obligimet të cilat i takojnë degës së IRDK-së në Istog. Ai theksoi se IRDK duhet të veproi konform rrethanave që zhvillohen, pra nëse në vitin 2000 jemi organizuar që të mbrojmë qenien tonë, tani ne duhet të reformohemi, të krijojmë struktura të qëndrueshme dhe të këmbëngulim në realizimin e të drejtave dhe në asnjë mënyrë mos të pranojmë si diçka të zakonshme diskriminimin. Në rrethanat e reja, nuk duhet pritur që pushteti do të na lehtëtojë dhe të na bëjë oferta se për çka keni nevojë. Kjo nuk do të ndodhë kurrë, theksoi ai, por kërkesat tona duhet mirë artikuluar dhe nëse është e nevojshme duhet të organizojmë protesta dhe demonstrata dhe në asnjë mënyrë të mos bëhemi pesimist sepse pesimizmi jonë nuk dërgon askund, përkundrazi pesimizmi na kthen mbrapa dhe populli jonë nuk ka kthim mbrapa. Për të qenë më shumë aktiv në komunën e Istogut ai theksoi që Abedin Neziraj, sekretar i degës, i cili së fundit ka diplomuar në shkencat kompjuterike, që ai të merret me organizimin e të rinjve të Istogut, ndërsa gjatë muajit

mars do të identifikohen të gjitha nevojat dhe problemet dhe ato do të detajizohen në formë të planit të veprimit i cili do të dorëzohet në institucionet lokale. Kryetari i IRDK-së Xhevdet Neziraj theksoi ndër të tjera se në rrethanat e reja kemi nevojë që të organizohemi më mirë në mënyrë që të demonstrojmë seriozitetin tonë për të qenë në pozitë të duhur. Ai theksoi se aty ku kemi rast i shprehim shqetësimet lidhur me pozitën jo të mirë të komunitetit egjiptian dhe theksoi se ka pasur takime me zyrtaret e ambasadave të shteteve më të fuqishme që veprojnë në Kosovë, me përfaqësuesin e Bashkimit Evropian në Kosovë. Në të gjitha këto takime i kam shprehur faktin e jo përfaqësimit dhe të papunësisë së shprehur në radhët e komunitetit egjiptian. Të pranishmit në këtë takim shprehen pakënaqësitë e tyre lidhur me të punësuarit nga radhët e komunitetit egjiptian në komunën e Istogut, lidhur me mos pagesës së udhëtimit për nxënësit që vijnë shkollën fillore dhe të mesme si dhe shqetësime tjera. Fazli Stollaj duke i mirëkuptuar shqetësimet e ngritura theksoi se është e pamundur që gjithmonë kërkesat dhe nevojat e adresuara të zgjidhen për shkak se kjo është në duart e atyre që mbajnë pushtetin dhe këta të fundit nuk janë gjithmonë të përgjegjshëm përkundër insistimit tonë. Në ditët në vijim në komunën e Istogut do të hartohen nevojat e detajuara të komunitetit egjiptian të komunës së Istogut dhe do të dorëzohen komunës së Istogut dhe do të bëhet organizimi i të rinjve të cilët do të jenë pjesë e të rinjve të IRDK-së.



Pamje nga takimi në degën e Istogut

Takimi i IRDK-së dega në Pejë



Pamje nga takimi në degën e Pejës

Iniciativa Re Demokratike e Kosovës në kuadër të organizimit të strukturave të Partisë gjatë muajit Shkurt organizoi dy takime të Kryesisë së degës në Pejë. Kryetari i degës së Pejës informoi Kryesinë në detaje për punën e grupit punues të emëruar për hartimin e planit të veprimit për 2013, për përmbajtjen e tij dhe obligimet e dala nga plani i veprimit për degët e IRDK-se. Kryesia e IRDK-se dega në Pejë me propozim të Kryetarit emëroi grupin punues për organizimin e Kuvendit të Forumit Rinor, ky

grup i përbërë nga Avdyli Berisha, Mergim Neziraj, Mahir Zeqiri dhe Shefqet Radoviqi ka për obligim të hartoj listën e delegateve potencial të cilët do të përfaqësoj të gjitha zonat e qytetit dhe fshatrat e Komunës së Pejës. Në kuadër të avancimit të raporteve IRDK-anëtarësi, Kryesia e Degës në Pejë vendosi të organizoj takime të rregullta me komunitetin me qëllim të informimit rreth zyrës së re, mundësisë së takimit me përfaqësues lokal dhe Kryetarin e Partisë për probleme me të cilat ballafaqohen qytetaret. Me 23 Shkurt, është organizuar takimi i parë me përfaqësues të komunitetit egjiptian të cilët janë pjesë e nën degës Qyshk- Sverrk, ku prezent në takim ishte edhe Kryetari i IRDK-se Xhevdet Neziraj. Në takim është diskutuar rreth situatës aktuale të egjiptianëve në këtë bashkësi territoriale. Angazhimi kryesor i degës së Pejës gjatë muajit shkurt ka qenë diskutimi rreth organizimit të një regjistrimi intern të popullatës egjiptiane në Komunën e Pejës, të dhëna të cilat do të na mundësonin që të krijohet një raport gjithëpërfshirës mes qytetareve dhe IRDK-se. Vendimi është marrë nga kryesia e degës dhe është në fazën e konsultuesë me qytetar dhe dokordimit rreth përmbajtjes së tij.

Letër drejtuar Kryetarit të Komunës së Istogut lidhur me përpjekjet e fundit për të implementuar Strategjinë e Qeverisë për Integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në komunën e Istogut

Përpjekjet e disa OJQ-ve për hartimin dhe implementimin e të ashtuquajturës "Strategjia e Qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës 2009 - 2015" është edhe një veprim i zakonshëm i këtyre OJQ-ve për t'i siguruar vetvetes fonde dhe për të mos bërë asgjë për komunitetet të cilat përmenden në ato strategji. Më duhet të ju përkujtoj se në komunën e Istogut, sipas evidencave tona, momentalisht jetojnë rreth 2500 pjesëtarë të komunitetit egjiptian, rreth 80 pjesëtar të komunitetit rom dhe asnjë pjesëtar i komunitetit ashkali. Gjithashtu, ju e dini se unë jam përfaqësues i komunitetit egjiptian në komunën e Istogut, i mandatar nga zgjedhjet lokale, dhe në mënyrë të vazhdueshme i kam artikuluar nevojat dhe kërkesat e këtij komuniteti. Komuna e Istogut nuk duhet lejuar që të përsëritet skenari i hartimit të Strategjisë në Qeverinë e Kosovës, kur dihet shumë mirë se kjo strategji është servuar nga OJQ dhe është financuar nga Fondacione Ndërkombëtare. Nuk ka dyshim se kjo ishte paaftësi e Qeverisë së Kosovës për të hartuar vet strategji por po konsumon diçka të servuar dhe shumë pak merret me këtë dokument. Tani disa OJQ kanë në shënjestër komunën e Istogut dhe për interesat e tyre po e vendosin komunën e Istogut në lajthitje duke e provuar nëse komuna do të nënshkruaj vet paaftësinë e saj që të merret me 2500 qytetaret e komunitetit egjiptian dhe 80 qytetarët e komunitetit rom. Nëse është e nevojshme që të hartohen plane të veprimit, ose strategji të caktuara për komunitetin egjiptian dhe komunitetin rom, atëherë komuna e Istogut ka mekanizma të mjaftueshëm që vetë të bëjë këtë punë. Në cilësinë e përfaqësuesit të komunitetit egjiptian në komunën e Istogut iu rekomandoj që komuna e Istogut mos të hartoj asnjë strategji lokale ose plan të veprimit i cili bazohet në Strategjinë e Qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës 2009 - 2015, për shkak se ky dokument cenon identitetin e komunitetit egjiptian dhe nuk është i bazuar në nevojat reale të komunitetit egjiptian në Kosovë. Unë si përfaqësues i komunitetit egjiptian në komunën e Istogut brenda dy muajve do t'ju sjellë planin e veprimit i cili evidenton nevojat reale të komunitetit egjiptian në komunën e Istogut. Nëse ju nënshkruani marrëveshje me OJQ për të hartuar plane të veprimit që si burim e kanë Strategjinë e Qeverisë së Kosovës, unë do të bëjë thirrje komunitetit egjiptian që të mos bashkëpunojnë me OJQ-të e autorizuara nga komuna për të hartuar plane boshe të veprimit të cilat nuk kanë asnjë vlerë.

Fazli Stollaj

Plani i Veprimit të IRDK-së për vitin 2013

Hyrje

Plani i Veprimit i IRDK-se për vitin 2013 është rezultat i grupit punues të emëruar nga Kryetari i partisë me qëllim të analizimit të situatës aktuale në vend dhe pozitës së Egjiptianëve në Kosovë me qëllim që angazhimi i strukturave të partisë të jetë në harmoni me kohën dhe interesat e egjiptianëve në Kosovë.

Ky plan veprimi do të shërbejë që aktivitetet e organeve të partisë të jenë të harmonizuar dhe koordinuar me qëllim të performancës me të mirë të strukturave partiake që do të ndikojnë në fuqizimin e partisë, avancimin e programit social demokratik dhe përfaqësimin me të mirë të interesave të komunitetit egjiptian në Institucionet lokale dhe qendrore.

Plani i Veprimit do të jetë udhërrëfyes i aktiviteteve dhe angazhimeve të strukturave partiake për vitin 2013 dhe si i tillë do të miratohet nga Kryesia e Partisë dhe do të shërbejë si instrument i matjes së performancës individuale dhe strukturës partiake.

Kryetari i Partisë është përgjegjësi kryesor për implementim të këtij plan-veprimi i cili për pjesë të caktuara të aktiviteteve të Planit të veprimit mund të autorizoj anëtar të Kryesisë së Partisë për menaxhim të aktiviteteve/projekteve.

Objektiva Gjenerale

Promovimi i identitetit të veçantë Egjiptian në Kosovë, krijimi i raporteve me shtetin e origjinës dhe njohja e Egjiptianëve në Ballkan nga strukturat shtetërore Egjiptiane.

Promovimi dhe mbrojtja e interesave politike, kulturor dhe socio ekonomik të egjiptianëve në Kosovë, faktorizimi i egjiptianëve në mjediset ku ata përbejnë një përqindje të konsiderueshme të popullatës lokale.

Objektivat Specifike

- 1.1 Organizimi i takimeve me përfaqësues të institucioneve shtetërore, përfaqësues të akredituar në Kosovë, partive politike dhe subjekteve tjera relevante vendore dhe nderkomebrate për avancimin e interesave politik, kulturor dhe socio-ekonomik të egjiptianëve në Kosovë.
- 1.2 Avancimi i Dialogut Egjiptian-Ashkali, përafrimi i qëndrimeve të përbashkëta në fusha të interesit Kombëtar, Strategji të përbashkëta kundër politikave "RAE", Edukim, Përafrimet Politike në Kuvendin e Kosovës.
- 1.3 Fuqizimi i Strukturave të Partisë në nën degë, degët Komunale, Kryesi dhe Këshilli Drejtues duke zbatuar politika gjithë përfshirëse dhe stimulim të iniciativave të strukturave dhe anëtarëve nga Menaxhmenti i Partisë duke krijuar politika të inkuadrimin të Kuadrove të Reja.
- 1.4 Avancimi i raporteve me votuesit e IRDK-së, krijimi i mundësive të takimit të rregullt formal dhe jo formal me anëtarësinë me qëllim të identifikimit të nevojave të komunitetit dhe mbrojtjen e interesave.

Aktivitete

1). Takimet Protokulare me Institucionet Shtetërore dhe Organizatat Ndërkombëtare

- 1.1 Takimet me bartës të institucioneve shtetërore do të shfrytëzohet që të ngritën çështje konkrete me interes të komunitetit egjiptian në Kosovë. Këto takime do të kenë karakter avokues dhe lobues të cilat IRDK do të shfrytëzoj për përmirësimin e jetës së egjiptianëve në Kosovë, avancimin e interesave Kombëtare dhe faktorizimin e IRDK-së si përfaqësuese legjitime e komunitetit në raport me institucionet shtetërore dhe ndërkombëtare.
- 1.2 Identifikimi i institucioneve me të cilat do të organizohen këto takime do të bazohet në propozimet e Kryetareve të Degëve, anëtareve të Kryesisë së IRDK-së dhe situatës aktuale politike në vend, Kryetari i IRDK-se do të cakton dhe udhëheq delegacionin e IRDK-së në këto takime.

2). Avancimi i Dialogut të Përafrimit Egjiptian-Ashkali

Platforma e Diskutimit dhe e Aprovuar nga Këshilli Drejtues i IRDK-së.

3). Fuqizimi i Strukturave të Partisë

- 3.1 Krijimi i mekanizmave që Kryesia dhe Këshilli Drejtues i Partisë të aktivizohet në përkrahje direkte të Degëve, në identifikimin e kuadrove, aktivisteve potencial për inkuadrim në Parti
- 3.2 Nga Kryetaret dhe Kryesia e Degëve të kërkohet propozime konkrete për riorganizim në nivel Dege dhe nëndege.
- 3.3. Krijimi i Forumeve Rinore në nivel Dege dhe Qendror
- 3.4 Krijimi i Forumit të Gruas në Nivel Qendror

4). Avancimi i Raporteve IRDK-Anëtarësi

- 4.1 Krijimi i raporteve të drejtpërdrejta me anëtarësinë të cilat do të organizohen nga Administratori i Zyrës së IRDK-së.
- 4.2. Takime të rregullta me anëtarësinë në terren të organizuara nga Degët e IRDK-se
- 4.3 Takime të rregullta të Kryesisë së IRDK-së me Kryesinë e Degëve dhe anëtarësinë në degë të caktuara
- 4.4 Takime Jo formale me anëtarësinë në raste specifike.

Tabela Kohore e Aktiviteteve

Aktivitetet	J	SH	M	P	M	Q	K	G	Sh	T	N	DH
Takimet Protokollare												
Dialogu												
Fuqizimi i Strukturave												
Raportet IRDK Votues												



24 Qershori “Dita e Egjiptianëve” në Kosovë



Nr. 01-02/13
Fletushkë informative mujore
Janar dhe Shkurt, 2013

Dizajnimi:
Fazli Stollaj
Dërgoni vërejtjet dhe shkrime t e juaja në:
Info@irdk-kosova.org